V E N D I M
Nr.356, datë 12.6.1995

PËR MIRATIMIN E AKTEVE - TIP TË THEMELIMIT TE SHOQËRIVE SHTETËRORE

Në bazë të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transormimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e statutit-tip të shoqërive anonime shtetërore që i bashkëngjitet këtij vendimi, të cilat do të krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri anonime.
2. Miratimi i statutit-tip të shoqërive shtetërore me përgjegjësi të kufizuara që i bashkëngjitet këtij vendimi, të cilat do të krijohen nga transformimi i ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri me përgjegjësi të kufizuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

S T A T U T

I SHOQËRISË ANONIME
(TIP)

Në bazë të dispozitave të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", me autorizimin e ministrit të Financave_____
_____ z._____ nënshkruan statutin e shoqërisë anonime si më poshtë:

Neni 1
Emërtimi dhe selia

Shoqëria anonime krijohet nga transformimi i ish-ndërmarrjes shtetërore_____
ose i (uzinës, repartit, sektorit) të ish-ndërmarrjes shtetërore_____.
Shoqëria e krijuar në këtë mënyrë emërohet_____
ose shkurt_____.
Selia e shoqërisë është_____

Neni 2
Objekti i shoqërisë

Objekti i shoqërisë është_____
_____
_____
Shoqëria, brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive të reja, krijimin e sipërmarrjeve të tjera dhe pjesëmarrjen në sipërmarrje të tjera si brenda, ashtu dhe jashtë vendit.

Neni 3
Kapitali fillestar - aksionet

Kapitali themeltar i shoqërisë është_____ lekë.

Ai është i ndarë në _____ aksione të së njëjtës kategori, të cilat zotërohen tërësisht nga shteti.

Vlera nominale e aksionit është_____ lekë.

Neni 4

Shitja e aksioneve në rastin e privatizimit

Aksionet e shoqërisë mund t'u shiten personave fizikë e juridikë shqiptarë vetëm me rastin e një vendimi të marrë për privatizimin e shoqërisë nëpërmjet bonove të privatizimit dhe/ose lekëve të privatizimit.

Personat e huaj, fizikë a juridikë, mund të blejnë aksione vetëm në rastet dhe në masën e caktuar nga ministri i Financave. Shlyerja e aksioneve nga personat e huaj, fizikë a juridikë, bëhet vetëm me para ose me anën e kontributeve në natyrë për qëllime teknologjike.

Neni 5

Organet drejtuese

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Këshilli mbikëqyrës.
2. Drejtori i përgjithshëm.

Neni 6

Këshilli mbikëqyrës

I. Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga_____ anëtarë.

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës emërohen:

1/3 nga_____

2/3 nga ministri i Financave.

II. Kohëzgjatja e funksionit të tyre është 4 vjet. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës janë të gjithë të rizgjedhshëm. Ata mund të revokohen nga titullari i organit që i ka emëruar vetëm për shkaqe të përligjura.

III. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës janë persona fizikë. Ata nuk mund të jenë të punësuar në shoqëri.

IV. Nëse një ose disa vende të anëtarëve të këshillit të mbikëqyrjes mbeten bosh për shkak vdekjeje, shkarkimi ose dorëheqjeje, zëvendësimi duhet të kryhet jo më vonë se tre muaj.

Anëtari i këshillit mbikëqyrës, i emëruar në zëvendësim të një anëtari tjetër, përfundon mandatin e paraardhësit.

V. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të bëjnë pjesë në më shumë se tre këshilla mbikëqyrës të shoqërive anonime që e kanë selinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

VI. Anëtarët e këshillit mbikëqyrës të moshës mbi 65 vjeç nuk mund të jenë më shumë se një e treta e emërimit të përgjithshëm në mbyllje të ushtrimit të çdo viti financiar. Nëse kjo përqindje tejkalohet, anëtari më i moshuar do të konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

Neni 7

Kryetari dhe zëvendëskryetari i këshillit mbikëqyrës

Këshilli mbikëqyrës zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një kryetar dhe një zëvendëskryetar, të cilët ngarkohen të mbledhin këshillin dhe të drejtojnë diskutimet. Ata emërohen për të gjithë kohën e mandatit të tyre në këshillin mbikëqyrës dhe janë të rizgjedhshëm.

Këshilli mbikëqyrës mund të emërojë një sekretar jashtë anëtarëve të tij.

Në rast mungese ose pengimi të kryetarit, mbledhjet e këshillit mbikëqyrës drejtohen nga zëvendëskryetari.

Neni 8
Vendimet e këshillit

Këshilli mbikëqyrës mblidhet sa herë që e kërkon interesi i shoqërisë, me thirrjen e kryetarit, ose në mungesë të tij, të zëvendëskryetarit.

Kryetari duhet të thërrasë këshillin mbikëqyrës brenda pesëmbëdhjetë ditëve, kur drejtori ose një e treta e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës i paraqitin atij një kërkesë të motivuar për këtë qëllim.

Nëse kërkesa mbetet pa përgjigje, atëherë anëtarët e saj mund të thërrasin këshillin, duke i përmendur rendin e ditës.

Në parim thirrja duhet të bëhet brenda tre ditëve më parë me letër, telegram, teleks, ose telefaks. Por ajo mund të bëhet me gojë dhe pa afat, në qoftë se anëtarët e këshillit mbikëqyrës e pranojnë atë.

Çdo thirrje duhet të tregojë çështjet kryesore të rendit të ditës.

Mbledhja e këshillit mbikëqyrës bëhet në selinë e shoqërisë, ose në çdo vend tjetër të treguar në thirrje.

II. Këshilli mbikëqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm, në qoftë se janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve të këshillit.

Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Në rast votash të barabarta, ajo e kryetarit është përcaktuese.

III. Këshilli mbikëqyrës mban një regjistër të pjesëmarrjes në mbledhjet e tij, i cili nënshkruhet nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.

IV. Vendimet e këshillit mbikëqyrës evidencohen me procesverbale të hartuara në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, nga kryetari i seancës dhe nga një anëtar i këshillit ose, në mungesë të kryetarit, nga jo më pak se dy anëtarë të këshillit.

Kopjet e këtyre procesverbaleve vërtetohen nga kryetari i këshillit mbikëqyrës, zëvendëskryetari dhe nga drejtori i përgjithshëm.

Neni 9
Kompetencat e këshillit mbikëqyrës

Këshilli mbikëqyrës ushtron kontroll të përhershëm për administrimin e shoqërisë nga drejtori i përgjithshëm i saj dhe i jep këtij të fundit autorizimin paraprak për kryerjen e operacioneve që nuk mund të kryhen nga drejtori i përgjithshëm pa autorizimin paraprak të këshillit mbikëqyrës.

Këshilli mbikëqyrës emëron drejtorin e përgjithshëm.

Ai autorizon marrëveshjet e parashikuara në nenin 13 të këtij statuti.

Ai autorizon drejtorin e përgjithshëm të kryejë veprimet dhe të marrë masat e parashikuara në nenin 7 të këtij statuti.

Këshilli mbikëqyrës ka të drejtë të kryejë në çdo kohë verifikime dhe kontrolle që ai i çmon të përshtatshme, dhe kërkon të njihet me dokumentet që ai i gjykon të nevojshme për përmbushjen e detyrës së tij.

Drejtori i paraqet raport këshillit mbikëqyrës të paktën një herë në muaj.

Brenda tre muajve nga data e mbylljes së ushtrimit financiar, drejtori duhet t'i paraqesë këshillit mbikëqyrës llogaritë vjetore me qëllim verifikimi dhe kontrolli të tyre nga ky i fundit.

Këshilli mbikëqyrës miraton llogaritë vjetore dhe raportin vjetor të paraqitur nga drejtori i përgjithshëm.

Këshilli mbikëqyrës mund t'i ngarkojë njërit ose disa anëtarëve të tij çdo mandat të posaçëm për një ose disa objekte të caktuara.

Neni 10
Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës

Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për këtë qëllim.

Neni 11
Drejtori i përgjithshëm

I. Drejtori i Përgjithshëm emërohet nga këshilli mbikëqyrës, kur për të janë dakord jo më pak se 3/4 e anëtarëve të këtij këshilli. Ai mund të zgjidhet qoftë ndërmjet personave të shoqërisë, qoftë edhe jashtë të punësuarve të saj.

Nëse një anëtar i këshillit mbikëqyrës emërohet drejtor, mandati i tij në këshill merr fund me hyrjen e tij në funksion.

Një person nuk mund të emërohet drejtor në më shumë se një shoqëri.

Drejtori mund të shkarkohet nga këshilli mbikëqyrës për shkaqe të arsyetuara. Në rastin kur i interesuari ka lidhur një kontratë punësimi me shoqërinë, shkarkimi i tij nga funksioni i drejtorit nuk është shkak për zgjidhjen e kësaj kontrate.

II. Drejtori emërohet për një periudhë kohe prej 4 vjetësh. Në rastet e pushimeve dhe të mungesave të tjera të zgjatura, këshilli mbikëqyrës bën menjëherë zëvendësimin e tij.

Drejtori është i riemërueshëm. Ai nuk mund të jetë në moshën mbi 65 vjeç.

Drejtori që mbush moshën 65 vjeç, quhet zyrtarisht i shkarkuar dhe zëvendësohet menjëherë.

Mënyra dhe masa e shpërblimit të drejtorit caktohen nga këshilli mbikëqyrës në akin e emërimit të tij.

Neni 12
Kompetencat e drejtorit

I. Drejtori ka kompetenca të plota ndaj të tretëve për të vepruar në emër të shoqërisë në çfarëdo rrethane, me përjashtim të kompetencave që i janë caktuar shprehimisht këshillit mbikëqyrës dhe nga ky statut.

Në marrëdhënie me të tretët shoqëria merr përsipër detyrimet që rrjedhin nga aktet e drejtorit, edhe kur këto akte nuk përfshihen në objektin e shoqërisë, përveç rastit kur shoqëria provon se të tretët e dinin që akti i drejtorit kapërcente objektin e shoqërisë dhe vepronte me keqbesim, ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt, duke pasur parasysh faktin se vetë shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Kufizimet e kompetencave të drejtorit të caktuara në statut duhet të respektohen nga të tretët.

Megjithatë, në cilësinë e masave të rregullimeve të brendshme të shoqërisë, por që nuk u kundërvihet të tretëve, veprimet dhe masat e mëposhtme kryhen vetëm me autorizim të këshillit mbikëqyrës:

- përcaktimi dhe ndryshimi i programit të veprimtarisë afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të shoqërisë;
- kryerja e investimeve dhe financimeve për vitin financiar si dhe masat e tjera që do të kërkonin ndryshimin e buxhetit fillestar të shoqërisë;
- hapja e veprimtarive ose e njësive të reja, shkrirja ose bashkimi dhe mbyllja tërësisht a pjesërisht e veprimtarive dhe njësive të shoqërisë;
- blerja, shkëmbimi dhe shitja e pasurive që përbëjnë aktivin e qëndrueshëm të shoqërisë;
- themelimi i shoqërive ose pjesëmarrja në shoqëri të tjera të krijuara, ose për t'u krijuar;
- marrja e huave afatmesme, afatgjata, dhënia e dorëzanive ose e garancive të tjera, kur këto të fundit tejkalojnë veprimtarinë e zakonshme të shoqërisë;
- negocimi, përfundimi a ndryshimi i çdo kontrate me afat mbi 3 vjet ose për një shumë detyrimesh vjetore mbi milionë lekë.
- përcaktimi i kritereve për diskutimin, përfundimin dhe ndryshimin e kontratës së punësimit me punonjësit;
- në përgjithësi marrja e vendimeve dhe masave që e kapërcejnë veprimtarinë e zakonshme të shoqërisë dhe që janë të tilla që mund të sjellin ndryshime në objektin e shoqërisë.

II. Drejtori i përgjithshëm mund të delegojë një pjesë të kompetencave të tij, që ai i gjykon të dobishme tek një ose disa persona të tjerë që kryejnë funksione teknike në drejtim të shoqërisë.

III. Drejtori i përgjithshëm përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretët.

Emërimi dhe pushimi i tij duhet të publikohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Aktet, me të cilat shoqëria merr përsipër detyrimet ndaj të tretëve duhet të mbajnë

nënshkrimin e drejtorit të përgjithshëm, ose të personit të autorizuar rregullisht nga drejtori për këto akte.

Neni 13

Marrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe drejtorit ose një anëtari të këshillit mbikëqyrës

Çdo marrëveshje ndërmjet shoqërisë dhe drejtorit të përgjithshëm ose një anëtari të këshillit mbikëqyrës, qoftë e drejtpërdrejtë ose jo e drejpërdrejtë, duhet t'i nënshtrohet autorizimit paraprak të këshillit mbikëqyrës.

Kjo dispozitë është e zbatueshme edhe për marrëveshjet ndërmjet shoqërisë dhe një shoqërie tjetër, kur një anëtar i këshillit mbikëqyrës është edhe anëtar i këshillit mbikëqyrës të shoqërisë tjetër, me të cilën propozohet të lidhet marrëveshja.

Dispozitat e mësipërme nuk janë të zbatueshme për marrëveshjet që kanë të bëjnë me veprimet rrjedhëse të shoqërisë që kryhen në kushtet normale.

Drejtori ose anëtari i këshillit mbikëqyrës i interesuar duhet të njoftojë këshillin mbikëqyrës sapo merr dijeni për një marrëveshje, për të cilën zbatohen kërkesat e këtij neni të statutit. Anëtari i këshillit mbikëqyrës i interesuar nuk merr pjesë në votimin për dhënien e autorizimit.

Neni 14

Eksperti kontabël i autorizuar

Kontrolli ushtrohet nga_____ ekspertë (e) kontabël të autorizuar, të cilët emërohen nga këshilli mbikëqyrës dhe që kryejnë misionin e tyre në pajtim me ligjin.

Neni 15

Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor të çdo viti.

Përjashtimisht ushtrimi i parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar gjer më 31 dhjetor.

Neni 16

Inventari - llogaritë vjetore

Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj, në pajtim me kërkesat ligjore.

Në mbyllje të ushtrimit, drejtori harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogaritë vjetore për ushtrimin financiar.

Drejtori përgatit gjithashtu edhe raportin e administrimit për gjendjen e shoqërisë gjatë ushtrimit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara për të ardhmen, ngjarjet më të rëndësishme që kanë ndodhur gjatë periudhës nga data e mbylljes së ushtrimit financiar deri në datën e hartimit të këtij raporti, si dhe veprimtaritë e shoqërisë në fushën kërkimore-shkencore.

Neni 17

Rezultati i ushtrimit dhe caktimi i fitimeve

Rezultati i ushtrimit përcaktohet si diferencë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të ushtrimit, duke përfshirë te këto të fundit amortizimet dhe provizionet.

Nga fitimet e ushtrimit të pakësuara, kur është rasti, me humbjet e mëparshme, hiqen të paktën 5% për të krijuar rezervën e domosdoshme.

Heqja nga fitimet për rezervën e domosdoshme pushon së qeni e detyrueshme kur kjo rezervë arrin një të dhjetën e kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur një arsye çfarëdo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nën një të dhjetën e kapitalit.

Nga fitimet e ushtrimit të pakësuar, kur është rasti, me humbjet e mëparshme shoqëria do të heqë jo më shumë se 85% për krijimin e rezervës për zhvillim.

Shuma e fitimeve të mbetura pas heqjeve për krijimin e rezervave të përmendura më sipër përfaqëson dividentin, i cili derdhet në buxhetin e shtetit.

Duke përjashtuar rastin kur është vendosur zvogëlimi i kapitalit, nga fitimet e ushtrimit nuk bëhet asnjë heqje dhe asnjë derdhje dividendi, në qoftë se kapitalet e veta janë ose do të bëheshin më të vogla se shuma e kapitalit themeltar plus shumën minimale të kërkuar për rezervën e domosdoshme.

Në qoftë se ekziston një humbje, kjo mbartet për t'u përfshirë në fitimet e ushtrimeve të mëparshme deri në shuarjen e saj.

S T A T U T

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR, SHPK

Neni 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar emërtohet "_____ SHPK
Zyra e shoqërisë është e regjistruar në_____ (adresa)
Viti fiskal është viti kalendarik
Lajmërimet e shoqërisë do të bëhen në publikimin e autorizuar

Neni 2

Objekti i shoqërisë është_____

Brenda kuadrit të dispozitave ligjore, shoqëria ka të drejtë të marrë të gjitha masat dhe të kryejë çdo veprimtari të përshtatshme për arritjen e objektit të shoqërisë. Kjo përfshin gjithashtu krijimin e zyrave të tjera, blerjen dhe krijimin e ndërmarrjeve të tjera dhe interesin pjesëmarrës në ndërmarrje të tilla si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Neni 3

Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është_____lekë.

Kapitali i shoqërisë është i ndarë me kuota nga 1.000 lekë secila, zotëruesi i të cilave në masën 100% është shteti.

Neni 4

Kapitali i shoqërisë u kalon personave të tretë në rastin e privatizimit të shoqërisë dhe sipas akteve ligjore në fuqi për këtë qëllim.

Neni 5

Organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë:
1. Këshilli mbikëqyrës
2. Administratori (ose drejtori i përgjithshëm)

Këshilli mbikëqyrës

Neni 6

Anëtarët e këshilli mbikëqyrës emërohen
1/3 nga_____
2/3 nga ministri i Financave.

Këshilli mbikëqyrës përbëhet nga_____ anëtarë. Koha e ushtrimit të detyrës është 4 vjet për të gjithë anëtarët.

Anëtarët e këshillit mund të largohen nga detyra e tyre me anë të një kërkese me shkrim, e cila duhet t'i dërgohet kryetarit të këshillit mbikëqyrës brenda një periudhe prej dy javësh.

Neni 7

Këshilli mbikëqyrës mbikëqyr dhe është përgjegjës për shkarkimin e detyrave dhe mbrojtjen e të drejtave, të cilat i jepen atij sipas ligjit, statutit ose vendimit të partnerëve me tre të katërtat e shumicës. Kjo i jep atij të drejtën të emërojë dhe shkarkojë administratorët, të negociojë, të ndryshojë dhe të përfundojë kontratën e punësimit të administratorit, të autorizojë administratorët si të vetmit përfaqësues, të vendosë rregullat e brendshme për administratën, të japë udhëzime dhe miratim paraprak për masa të jashtëzakonshme dhe veprime që kalojnë veprimtarinë e zakonshme të shoqërisë.

Këshilli mbikëqyrës ka të drejtë të mbikëqyrë në çdo kohë drejtimin e plotë të administratorit (drejtorit të përgjithshëm) dhe në këtë mënyrë të gjitha regjistrimet, librat dhe objektet e shoqërisë mund të shihen dhe inspektohen.

Administratori (ose drejtori i përgjithshëm) është i detyruar të informojë këshillin mbikëqyrës sipas sferës së veprimtarisë të përcaktuar me ligj. Për më tepër këshilli mbikëqyrës mund të kërkojë paraqitjen e një raporti për problemet e shoqërisë, lidhjet ligjore dhe të biznesit me shoqëritë e tjera të lidhura, për aktivitetet e biznesit, të cilat mund të jenë domethënëse për pozitën e partnerëve.

Neni 8

Përfaqësuesi i përhershëm i këshillit mbikëqyrës kundrejt të tretëve është kryetari, në mungesë të tij, zëvendësi.

Neni 9

Këshilli mbikëqyrës zgjedh ndër anëtarët e tij një kryetar dhe një zëvendës për kohën e ushtrimit të detyrës të përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti. Zgjedhja e tyre bëhet në mbledhjen e parë. Në qoftë se kryetari ose zëvendësi i tij largohen nga detyra para mbarimit të afatit, atëherë do të kryhet një zgjedhje tjetër për periudhën e mbetur nga koha e uhstrimit të detyrës së personave që janë larguar.

Në pamundësi ardhjeje të kryetarit dhe të zëvendësit të tij, gjatë kësaj kohe detyrat do të kryhen nga anëtari më i vjetër në moshë.

Këshilli mbikëqyrës mund të përcaktojë rregulla të brendshme lidhur me procedurën e punës. Vendimet merren vetëm nga këshilli mbikëqyrës me shumicë absolute të anëtarëve pjesëmarrës në mbledhje.

Administratori (ose drejtori i përgjithshëm) merr pjesë në mbledhjen e këshillit. Këshilli mbikëqyrës mund të marrë vendim tjetër për pjesëmarrjen e administratorit në mbledhje.

Gjatë kryerjes së detyrave të tij, këshilli mbikëqyrës mund të vlerësojë vetë mbi kualifikimin e palës së tretë për mbështetjen e tij. Gjithashtu pala e tretë mund të marrë pjesë në mbledhje si këshilluese.

Neni 10

Mbledhjet e këshillit mbikëqyrës thirren me shkrim nga kryetari dhe, në pamundësi ardhjeje, nga zëvendësi i tij. Lajmërimi bëhet 15 ditë përpara. Në raste urgjente lajmërimi mund të bëhet brenda një kohe më të shkurtër dhe ftesa mund të komunikohet gojarisht, me telefon, teleks ose telegram.

Në këtë ftesë duhet të specifikohen rendi i ditës dhe sugjerimet e vendimeve.

Ndonjë anëtar i këshillit mbikëqyrës mund të shtrojë çështje në rendin e ditës, të cilat duhet t'i bëhen të njohura kryetarit me anë të një letra të paktën 10 ditë para mbledhjes. Të gjithë anëtarët e tjerë të këshillit duhet të informohen pa vonesë për shtesat në rendin e ditës.

Neni 11

Nëse të gjithë anëtarët e këshillit mbikëqyrës janë ftuar në kohën e duhur dhe nëse të paktën gjysma e numrit legal të tyre merr pjesë në miratimin e një vendimi, atëherë këshilli mbikëqyrës formon një kuorum (numër anëtarësh që duhet të jetë prezent për të konsideruar një mbledhje të vlefshme). Miratimi i një rezolute, e cila nuk ka qenë e përfshirë në rendin e ditës të përcaktuar, është

e lejueshme vetëm nëse asnjë nga anëtarët e pranishëm të këshillit mbikëqyrës nuk kundërshton rezolutën dhe të paktën dy të tretat e anëtarëve janë të pranishëm.

Mbledhja do të drejtohet nga kryetari dhe, në pamundësi të tij, nga zëvendësi. Kryetari vendos radhën e trajtimit të çështjeve në rendin e ditës, llojin dhe radhën e votimit.

Vendimet e këshillit mbikëqyrës do të miratohen me shumicë të thjeshtë, me përjashtim të rasteve kur ligji e parashikon ndryshe. Kjo është e vlefshme edhe për votimin.

Në rast barazimi votash, do të ndërmerret një tjetër diskutim lidhur me çështjen konkrete, vetëm nëse shumica e këshillit mbikëqyrës vendos për këtë, përndryshe do të bëhet një votim tjetër i menjëhershëm. Nëse edhe rezultati i votimit të dytë është i barabartë, atëherë vota e kryetarit është përcaktuese.

Neni 12

Procesverbalet e mbledhjeve të këshillit mbikëqyrës dhe të komiteteve, nëse ekzistojnë, duhet të përgatiten e të nënshkruhen nga drejtuesi përkatës i mbledhjes.

Neni 13

Anëtarët e këshillit mbikëqyrës duhet të ruajnë mënyrën e gjykimit dhe të veprimit, duke trajtuar në mënyrë konfidenciale, informacionin dhe sekretet e shoqërisë, veçanërisht ato industriale dhe të biznesit, për të cilat ata janë bërë të vetëdijshëm nëpërmjet punës së tyre. Kjo mbetet e vlefshme edhe pas largimit nga këshilli mbikëqyrës. Informacioni lidhur me shoqërinë mund t'i transferohet palëve të treta vetëm me miratimin e kryetarit të këshillit mbikëqyrës dhe me kusht që transferimi nuk rrezikon interesat e shoqërisë.

Në qoftë se palët e treta kanë marrë pjesë në mbledhjet e këshillit mbikëqyrës, ato duhet gjithashtu të ruajnë maturinë.

Neni 14

Shpërblimi i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës bëhet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Administratori (ose drejtori i përgjithshëm)

Neni 15

Shoqëria mund të ketë një ose disa administratorë.

Administratorët emërohen nga këshilli mbikëqyrës. Emërimi mund të revokohet në çdo kohë, veçanërisht në rastet kur ka arsye të rëndësishme.

Përfundimi i kontratës së punësimit të administratorit është në kompetencë të këshillit mbikëqyrës.

Neni 16

Administratori është i detyruar të drejtojë shoqërinë në përputhje me ligjin, këtë statut, vendimet e këshillit mbikëqyrës dhe sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Nëse administrata përbëhet nga disa persona, do të krijohen rregullat e brendshme të cilat i nënshtrohen miratimit të këshillit mbikëqyrës.

Administratori (ose drejtori i përgjithshëm) është i detyruar para shoqërisë të respektojë rregullat e parashikuara nga ligji, statuti, asambleja e partnerëve ose këshilli mbikëqyrës brenda sferës së autoritetit të tij drejtues.

Për të gjitha masat ose veprimet që e kalojnë veprimtarinë e tij të zakonshme, administratori kërkon miratim paraprak sipas një vendimi të këshillit mbikëqyrës.

Neni 17

Shoqëria përfaqësohet nga ana ligjore nga administratori (ose drejtori i përgjithshëm), nëse ai

është administratori i vetëm ose është i autorizuar nga këshilli mbikëqyrës si fuqia e vetme përfaqësuese.

Në qoftë se administrata përbëhet nga disa persona, anëtarët e administratës caktohen të përfaqësojnë shoqërinë vetëm bashkërisht. Këshilli mbikëqyrës mund të marrë ndonjë vendim tjetër.